

## Komunikatë për Shtyp

Lezhë, Kallmet më 19 Nëntor 2010

Me rastin e përfundimit të punimeve të segmentit rrugor Lezhë-Kallmet-Nënshat-Vau i Dejës, Komuna Kallmet, ditën e premte datë 19 Nëntor, 2010, nga ora 10.30 – 12.00, organizoi në qendrën e Komunës aktivitetin : “PROGRAMI I RRUGËVE DYTËSORE DHE LOKALE NË SHËRBIM TË BANORËVE TË KALLMETIT”.

Ky aktivitet është pjesë e aktiviteteve që kryhen në kuadër të grantit nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës (CEB) nëpërmjet Norway Trust Account. Ky grant akordohet për asistencën teknike për monitorim-vlerësimin dhe vizibilitetin e Programit “Rrugët Dytësore e Lokale”.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin autoritete të Qarkut Lezhë, Deputë të zonës, përfaqësues të qeverisjes vendore, nxënës dhe mësues të shkollës së mesme Kallmet, banorë të zonës si dhe përfaqësues nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit që ka implementuar projektin për rikonstruksionin e këtij segmenti rrugor.

Aktiviteti u hap nga Z. Petrit Marku, Kryetar i Komunës. Në emër të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, pjesëmarrësit në këtë aktivitet i përshëndeti Zoti Benet Beci, Drejtor Ekzekutiv i FSHZH-së. Më pas aktiviteti vijoi me një program artistik nga nxënësit e gjimnazit të Kallmetit. Në ambjentet e brendshme të komunës ishin afishuar stenda me informacionet kryesore për Programin e Rrugëve Dytësore, Donatorët, dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Për të sensibilizuar banorët dhe nxënësit për sigurinë rrugore dhe mirëmbajtjen e rrugës, grupe nxënësish shpërndanë fletëpalosje informuese. Në mbyllje të aktivitetit pjesëmarrësit u ftuan të ndiqnin një dokumentar të Fondit Shqiptar mbi investimet e kryera në Qarkun e Lezhës.

Rikonstruksioni i segmentit rrugor “Lezhë-Kallmet-Nënshat-Vau i Dejës” me gjatësi 33.7 km dhe gjerësi 5.8 m përfundoi në Gusht 2010. Financimi i këtij projekti me vlerë prej 774 milion lekë u mundësua nga OFID (Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar) dhe CEB (Banka Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës) në kuadër të Programit “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale” që po implementohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Rikonstruksioni i këtij segmenti rrugor ndihmon drejtpërsëdrejti në përmirësimin e jetesës së 11750 banorëve të Komunës Kallmet , Vau i Dejës e Blinisht pasi përmirëson kushtet e transportit në përgjithësi, shkurton ndjeshëm kohën e udhëtimit drejt qytetit të Shkodrës dhe Lezhës, ndihmon në uljen e kostos së udhëtimit , shton mundësitë e rritjes dhe tregtimit të prodhimit bujqësor e blegtoral.

Me mbështetjen e Fondit Shqiptar të Zhvillimit në Komunën Kallmet janë realizuar 7 projekte të infrastrukturës publike me një vlerë totale prej 590 milionë lekësh . Këtu përmenden

rikonstrukcioni i katër (4) segmenteve rrugore, dy ( 2) ujësjellësve, dhe i një (1) qendre shëndetësore.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit është një institucion që nxit një zhvillim social-ekonomik të qëndrueshëm, të balancuar dhe koheziv, në nivel rajonal e lokal, në mbështetje të politikave shtetërore të zhvillimit. Aktualisht FSHZH po realizon programin “Përmirësimi i Rrugëve Dytësore dhe Lokale në Shqipëri”, programin e “Ujësjetësve Ruralë ” si dhe programin “Punët Në Komunitet III”. Këto projekte mundësohen me financime nga Banka Botërore, Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës, Banka Gjermane KFW, Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), Banka Evropiane e Investimeve, Banka Islamike për Zhvillim etj.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit, që nga krijimi i tij në 1993, ka realizuar 127 projekte infrastrukture në Qarkun e Lezhës. Nga këto investime, në rrethin e Lezhës janë implementuar deri më sot 61 objekte të infrastrukturës parësore ; prej të cilave 20 janë ndërtime segmentesh rrugore, 23 ujësjellës-kanalizime, 6 vepra ujitje&mbrojtje nga përmytjet, 3 ndërtesa publike, 2 qendra shëndetësore, 1 Qendër Komunitare dhe 3 nënprojekte mjedisore dhe kulturore dhe dy vepra të tjera. Vlera totale e projekteve të financuara në këtë rreth deri në Tetor 2010 arrin shifrën prej 1,226,000,000 Lekë. Aktualisht, FSHZH është duke implementuar projektin për rikonstrukcionin e rrugës ish-SMT Lezhë-Rrilë.

Për më tepër informacion rreth ecurisë së projekteve të FSHZH-së, mund të vizitoni faqen e internetit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit:

[www.albaniandf.org](http://www.albaniandf.org)

ose na kontaktoni në adresën tonë të e-mailit :

[adf@albaniandf.org](mailto:adf@albaniandf.org)